



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 66, datë 16.06.2022

PËR

MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEKSIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR. 14, RRUGA “PETRAQ BOSHNJAKU” NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, DUKE PËRFSHIRË Z. FATMIR TAULLAI

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Ligjit nr. 22, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, VKM nr.301 datë 15.04.2020, “Për normat e strehimit”, VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të proçesit të rindërtimit”, VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, VKM-së nr.329, datë 16.05.2021 “Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, kërkesës nr. 5365 prot., datë 13.06.2022 të kryetares së Bashkisë Durrës, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 25.02.2021 “Për miratimin e listës të subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit për pallatin nr. 1062, rruga “26 Nëntori” dhe pallatin nr. 14, rruga “Petraq

Boshnjaku” njësia administrative nr. 2, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, raportit të Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike me nr. 471/33 prot., datë 10.06.2022, si edhe sipas Rregullores së Funkionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, me propozim të 2 (dy) Komisioneve të Përherhëm të Këshillit, Komisionit të Rregullores, Çështjeve Ligjore si dhe Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtesë në Aneksin nr.1 “Pallati nr. 1062, Rruga “26 Nëntori”, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 25.02.2021 “Për miratimin e listës të subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin nr. 1062, Rruga “26 Nëntori” dhe Pallatin nr. 14, Rruga “Petraq Boshnjaku”, Njësia Administrative nr. 2, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
2. Miratimin e përfshirjes në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 25.02.2021, përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Fatmir Taullai në masën e strukturës së njësisë së banimit 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Përfituesve nga Programet e Procesit të Rindërtimit dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 17.06.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 504/prot.
5

Durrës, më 17.06.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.66 datë 16.06.2022 Për miratimin e një shtese në aneksin nr 1, të VKB Nr 22 dt 25.02.2021 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr 1062 rruga “26 Nëntori” dhe pallatin nr 14, Rruga “Petraq Boshnjaku” Njësia Administrative Nr 2 të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019” duke përfshirë Z.Fatmir Taullai.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

